



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHIJAK  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3593 Prot.

Shijak, më 24 . 05 .2022

VENDIM  
Nr. 16 datë 23 . 05 .2022

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE  
TË HOLLËSISHME PËR MËNYRËN E ZHVILLIMIT TË PROCESIT TË  
SHORTEUT PUBLIK PËR NDARJEN E NJËSIVE TË BANIMIT NË OBJEKTET  
E REJA NË BASHKINË SHIJAK, NË KUADËR TË RINDËRTIMIT”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 54, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë dhe Lezhë”, i ndryshuar, Aktit normativ nr.9 datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Vendimit nr.904 datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar dhe me propozim të kryetarit të bashkisë, Këshilli i Bashkisë Shijak

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Rregullore për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mënyrën e zhvillimit të procesit të shorteut publik për ndarjen e njësive të banimit në objektet e reja në bashkinë Shijak, në kuadër të rindërtimit”.
2. Kryetari i Bashkisë të nxjerë aktet për ngritjen e komisioneve dhe grupet e punës, duke përcaktuar qartë të gjitha detyrat e përcaktuara në këtë rregullore.
3. Ndjek zbatimin e këtij Zv.kryetarët e bashkisë, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Sektori Juridik.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 55, pika 6.

**KRYETARI**  
**Tauland Xheraj**

